



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 24.1.2022

*Dokument parlamentar*

*Komision përgjegjës*

**R A P O R T**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN  
NR.112/2020, “PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES”, TË  
NDRYSHUAR**

***I. Hyrje***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 24.01.2022, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Zj. Antoneta Dhima.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent:

*Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Z. Besart Kadia Zv. Ministër dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.*

*Nga Qendra Kombëtare e Biznesit: Z. Flogers Broqi, Drejtor i Drejtorisë së Metodologjisë.*

***II. Baza ligjore Kushtetuese***

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 83 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji mbështetet në nenet 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

### ***III. Qëllimi, arsyet e ndërmarrjes së iniciativës dhe përmbajtja e projektligjit***

#### ***Qëllimi***

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një seti rregullash dhe procedurash për të bërë të mundur nxitjen e rritjes së numrit të raportimeve të pronarëve përfitues e për rrjedhojë popullimin sa më shumë të jetë e mundur të Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

Përmes plotësimit të këtij qëllimi njëkohësisht realizojmë dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të *MONEYVAL*-it, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma për sigurimin e një numri sa më të lartë të subjekteve raportuese, që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues.

Ky qëllim i projektligjit, synohet të arrihet përmes disa ndërhyrjeve në ligj, të cilat përmbledhtazi konsistojnë si më poshtë:

Projektligji krijon mundësinë që regjistri i pronarëve përfitues të popullohet me informacion në mënyrë automatike nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për të gjithë subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte;

Shtyhet afati për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese me pronësi indirekte të regjistruara në regjistrin tregtar dhe nga Organizatat Jofitimprurëse, deri më datë 1.4.2022;

Projektligji propozon futjen e procedure të reja thjeshtuese, si atë të aplikimit të njëkohshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues nga të gjitha subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, në momentin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik; Kjo procedurë do të ndiqet edhe për regjistrimin e pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar me pronësi direkte;

Propozohet një shtyrje e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, në 40 ditë kalendrike përkundrej afatit aktual 30 ditor.

Projektligji, gjithnjë në kuadër të përmbushjes së qëllimit të tij, sic më lart citova, ndër të tjera propozon edhe faljen e gjobave të vendosura nga Qendra Kombëtare e Biznesit në lidhje me mospërmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues nga subjektet raportuese, gjoba këto

të vendosuar përpara hyrjes në fuqi të këtij projektligji. Padyshim falja e gjobës nuk shmang detyrimin që raportimi të kryhet brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji.

Gjithashtu për të krijuar barasi midis subjekteve raportuese, projektligji ka parashikuar edhe rimbursimin e të gjithë subjekteve që I kanë paguar këto gjoba.

Projektligji, sjell gjithashtu edhe disa risi të tjera procedurale të cilat e përmirësojnë ndjeshëm atë të tillë si:

Parashikimi i përshkallëzimit të masës së kundërvajtjeve administrative, mbi bazën e vonesës në përmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi apo heqjen e gjobës për administratorin dhe kalimin e saj në ngarkim të subjekteve raportuese për rastet e mosregjistrimit të të dhënave;

Parashikimi i procedurave të pezullimit të aplikimit për 30-ditë, në rast të aplikimeve të paplota, kalimi në status “të pezulluar”, për subjektet raportuese, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues, brenda afateve të shtyra sipas parashikimeve të projektligjit si dhe vendosen klauzola për mos lejim të organeve shtetërore kompetente për të ofruar shërbimet ndaj këtyre subjekteve raportuese deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues;

### ***Përmbajtja***

Projektligji përmban 7 nene, gjithsej si më poshtë:

- Neni 1 i projektligjit ndryshon shkronjën pikën 3, të nenit 5, të ligjit, duke parashikuar aplikimin e njëkohshëm me regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar, në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen në regjistrin tregtar rishtazi, si dhe duke zgjatur afatin nga “30” ditë në “40” ditë
- Neni 2 i projektligjit ndryshon pikat 4, 6 dhe 8, të nenit 6, të ligjit, duke parashikuar paraqitjen e aplikimit të njëkohshëm dhe miratimin e njëkohshëm të regjistrimit të të dhënave për pronarët përfitues të subjekteve raportuese. Gjithashtu parashikohet procedura e pezullimit.
- Neni 3 i projektligjit ndryshon nenin 13, të ligjit duke parashikuar përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative si dhe rregullon ngërçin e mundshëm që mund të krijohet në lidhje me gjobat ndaj përfaqësuesve ligjor e ndryshimin e të dhënave të tyre në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.
- Neni 4 i projektligjit shfuqizon pikën 3, të nenin 15, lidhur me afatin e regjistrimit që zbatohet ndaj subjekteve raportuese ekzistuese, të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore.
- Neni 5 i projektligjit përmban dispozita transitorë. Kështu parashikohet mundësia që QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, të popullojnë automatikisht Regjistrin e Pronarëve Përfitues për subjektet raportuese

ekzistuese që kanë pronësi direkte, të cilat kanë qenë të regjistruara në Regjistrin Tregtar, përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, duke iu referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar. Përmban dispozita për faljen e gjobave të papaguara, të vendosura nga QKB-ja, si dhe parashikon rimbursimin e gjobave që falen, nga subjektet që i kanë paguar ato.

- Neni 6 i projektligjit përmban afatin për miratimin nga ana e Këshillit të Ministrave, të akteve nënligjore
- Neni 7 i projektligjit parashikon dispozitën e hyrjes në fuqi.

#### **IV. Zbatimi i projektligjit:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e ligjit, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe institucionet e tjera përgjegjëse. Përkatësisht:

Qendra Kombëtare e Biznesit e cila do të jetë përgjegjëse për: Regjistrimin, administriminë, përpunimin dhe ruajtjen në regjistër të dhënave të deklaruara nga subjektet raportuese; Mundësimin e disponueshmërisë së të dhënave të Regjistrit; Lëshimin e ekstrakteve për të dhënave të regjistruara në regjistër; Ndërmarrjen e veprimeve të tjera në përputhje me këtë ligj.

AKSHI, i cili do të jetë përgjegjës për popullimin automatik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

#### **V. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire**

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

#### **VI. Efektet Financiare**

Projektligji mbart efekte financiare për shkak të parashikimit të faljes së gjobave të papaguara nga subjektet raportuese që kanë kryer kundërvajtjeve administrative si dhe të rimbursimit të gjobave të paguara nga subjektet që kanë kryer kundërvajtjeve administrative.

Bazuar në të dhëntë e pasqyruara në relacionin shoqërues të projektligjit rezulton si më poshtë:

Në total nga QKB, janë vendosur 927 gjoba ndaj subjekteve raportuese nga të cilët 109 subjekte raportuese kanë paguar gjobën përkatëse dhe kanë kryer regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

Më specifikisht rezulton:

- *Për mospërbushjen e detyrimit të regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues*
  - a) Jane vendosur 788 gjoba në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj subjekteve raportuese ekzistuese, dhe në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit,
  - b) Nga subjektet e shkronjës “a”, 97 subjekte raportuese kanë paguar gjobën në masën 400 000 lekë.
- *Për mos përbushje të detyrimit pas krijimit të regjistrit të pronarëve përfitues*
  - a) 139 gjoba në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ndaj subjekteve raportuese të regjistruara, si dhe në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë ndaj përfaqësuesit ligjor të subjektit.
  - b) 12 subjekte raportuese kanë paguar gjobën prej 650 000 lekësh dhe kanë kryer regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

Nga të dhënat e mësipërme të hedhura në formë tabelare rezulton se:

Në lekë

Lloji i shkeljes	Gjoba gjithsej	Masa gjobës	Gjobat e Pa paguara	Vlera gjobave ta pa paguara	Gjobat e paguara	Vlera gjobave e te paguara
Mos regjistrim fillestar I pronarëve përfitues	788	400 000	691	276 400 000	97	38 800 000
Mosregjistrimi I subjekteve raportuese të regjistruara pas krijimit të regjistrit të pronarëve përfitues	139	650 000	127	82 550 000	12	7 800 000
<b>Totali</b>	<b>927</b>		<b>818</b>	<b>358, 950, 000</b>	<b>109</b>	<b>46, 600, 000</b>

- Në total sipas këtij ligji falen 818 subjekte, me gjobë në masën 358, 950, 000 lekë, çfarë përbëjnë edhe të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.
- Në total do të rimbursohen 109 subjekte në masën 46, 600, 000 lekë, çfarë përbëjnë edhe të ardhura që do të dalin nga Buxheti i Shtetit.

## VII. Shqyrtimi i projektligjit në komision:

Përfaqësuesit e Qeverisë bënë një përshkrim të detajuar të projektligjit si dhe të arsyeve se përse është ndërmarrë kjo iniciativë, cilat janë pritshmëritë dhe efektet financiare që ka projektligji.

Relatorja e Komisionit, në fjalën e saj, evidentoi qëllimin e projektligjit, objektivat që vlerësohen të arrihen përmes këtyre ndërhyrjeve ligjore, si dhe risitë që projektligji sjell.

Gjithashtu relatorja u ndal edhe në arsyet që diktuan ndërmarrjen e kësaj iniciative. Kështu, bazuar në ligjin nr. 9917/2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, subjektet e detyruara sipas këtij ligji, kishin detyrimin të identifikonin vetë pronarët përfitues të klientëve të tyre. Megjithatë, të dhënat e pronarëve përfitues të identifikuar nga këto subjekte të detyruara nuk kanë qënë të regjistruar në një regjistër kombëtar të posacem. Gjithashtu, subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë, bazuar në legjislacionin e asaj kohe, nuk kishin detyrimin të identifikonin dhe të rregjistronin në një regjister të posacëm kombëtar të dhënat për pronarët e tyre përfitues.

Ligji nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar me aktin normativ, plotësoi këtë vakum logjor dhe vendosi detyrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, deri më datë 30.6.2021, për të gjitha subjektet raportuese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Por pavarësisht këtij detyrimi ligjor, nga analizimi i të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, rezulton se:

- Nga 59165 subjekte raportuese ekzistuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar, përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues (prej të cilëve 8689 janë subjekte me statusin pezulluar), vetëm 21460 subjekte raportuese ekzistuese kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër deri më 10.11.2021,.
- Nga 4861 organizata jofitimprurëse ekzistuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, vetëm 1961 organizata jofitimprurëse kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.
- Nga 2869 subjekte raportuese të krijuara rishtazi pas krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues (gjatë periudhës kohore 1.2.2021-10.11.2021), vetëm 1972 subjekte kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Sa më sipër, bazuar në këtë kontroll “*ex post*” me synim vlerësimin e përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të synuara përmes miratimit të ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar dhe nga analizimi i rezultateve të prodhuara, është vlerësuar nevoja për ndërhyrje të menjëhershme, dhe përmirësime e ndryshime në këtë ligj për të garantuar përmbushjen e qëllimit për rritjen e numrit të raportimeve të pronarëve përfitues e për rrjedhojë popullimin sa më shumë të jetë e mundur të Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

Këto ndryshime ligjore diskutohen gjithashtu edhe nga nevoja për përmbushjen e rekomandimeve të ekspertëve të MONEYVAL-it, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma për sigurimin e një numri sa më të lartë të subjekteve raportuese, që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues.

Anëtarët e komisionit ngritën disa pyetje lidhur me arsyet e mosfunksionimit si duhet të ligjit deri më sot, mbi arsyen e shtyrjes së afatet edhe për pronarët përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen në regjistrin tregtar me pronësi indirekte si dhe nëse është parashikuar ndonjë masë pezulluese sidomos lidhur me pronarët përfitues në marrëdhënie të tilla me shtetin.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhanë sqarime të detajuara lidhur me të gjitha pyetjet apo shqetësimet e ngritura nga anëtarët e komisionit.

### ***VIII. Përfundime***

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të krijojë një set rregullash dhe procedurash për të bërë të mundur nxitjen e rritjes së numrit të raportimeve të pronarëve përfitues e për rrjedhojë popullimin sa më shumë të jetë e mundur të Regjistrin të Pronarëve Përfitues si dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të MONEYVAL-it, me votat pro të shumicës së anëtarëve të komisionit të pranishëm në mbledhje, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme.

- Neni 1, i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje:

#### **“Neni 1**

Në nenin 5, pika 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Regjistrimi nga subjektet raportuese, i të dhënave të pronarëve përfitues, në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, bëhet në afatet e mëposhtme:

- a) Në rastet e regjistrimit fillestar, të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, regjistrimi bëhet njëkohësisht me aplikimin për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar;
- b) Në rastet e refuzimit të aplikimit për regjistrimin fillestar, të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen në regjistrin tregtar me pronësi indirekte, regjistrimi bëhet brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike, nga data e refuzimit të aplikimit.

- c) Në rastet e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues, nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, regjistrimi bëhet, brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike, nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese si person juridik;
  - ç) Në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, regjistrimi bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike, nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik.”
- Në nenin 2 të projektligjit, i cili bën ndryshime në nenin 6 të ligjit (të cilit i referohemi në vijim), bëhen këto ndryshime:
    - Në pikën 1, paragrafi i parë i pikës 4 që ndryshohet, riformulohet me këtë përmbajtje:
 

“4. QKB-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e aplikimit nga subjektet raportuese, kryen njërin nga veprimet e mëposhtme:
    - Tek shkronja “c”, po në pikën 4 që ndryshohet, pas fjalës “nëse”, shtohen fjalët “pas verifikimit konstaton se”;
    - Fjalja e fundit e pikës së re të shtuar 4/2, riformulohet, me këtë përmbajtje:
 

“Nëse të metat nuk janë plotësuar, QKB-ja refuzon regjistrimin, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune, pas përfundimit të afatit të përcaktuar sipas shkronjës “b”, të pikës 4, të këtij neni.”
    - Pika 4, që ndryshon pikën 8 të nenit 6 të ligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:
 

“4. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Procedurat, rregullat, kriteret dhe shkaqet për ndërmarrjen e veprimit të pezullimit apo refuzimit nga QKB-ja, për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, miratohen më vendim të Këshillit të Ministrave.”.
  - Në nenin 3 të projektligjit, përmes të cilit riformulohet neni 13 i ligjit ekzistues bëhen ndryshimet si më poshtë:
    - Në pikën 6, referenca ligjore “në pikën 4, të nenit 9, të këtij ligji”, bëhet “në pikën 4, të nenit 9, të ligjit”
    - Në pikën 7, fjalët “Rregullat për mënyrën dhe afatet e komunikimit mes”, zëvendësohen me fjalët “Procedurat, afatet dhe rregullat e përgjithshme të administrimit dhe ndërveprimit përmes.”
  - Në nenin 5 të projektligjit, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
    - Titulli i nenit 5 hiqet, dhe në vend të tij, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
 

“Pas nenit 15, shtohet neni 15/1, me titull “Dispozita tranzitore”.



- Përmbajtja e nenit 5 të projektligjit, bëhet përmbajtja e nenit 15/1 të shtuar, me ndryshimet e mëposhtme:
  - Në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 15/1 të shtuar, data “1.4.2022”, zëvendësohet me datën “30.06.2022”.
  - Pika 1 e nenit 15 të shtuar, ndahet në dy pika, si më poshtë:
    - “1. QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, brenda datës 30.06.2022, transferon në Regjistrin e Pronarëve Përfitues të dhënat e pronarëve përfitues për subjektet raportuese me pronësi direkte, që kanë qenë të regjistruara në Regjistrin Tregtar përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.
    2. Për subjektet raportuese të dhënat e të cilëve janë transferuar sipas pikës 1, të këtij neni, detyrimi për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues quhet i përmbushur në datën e këtij transferimi. Këto subjekte raportuese kanë të drejtë të përditësojnë pranë QKB-së të dhënat e pronarëve të tyre përfitues pa u përballur me kundërvajtje administrative.”
  - Ndryshon numeracioni i pikave të tjera në vijim.
  - Në pikën 6, të nenit 15/1 të shtuar, që është bërë pika 7, fjalët “të përcaktuara sipas ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar,” hiqen.
- Neni 6, i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore për zbatimin e nenit 6, pika 8; nenit 13 pika 7 dhe nenit 15/1 pika 9, të ligji.”

**RELATOR**

**KRYETAR**

**Antoneta DHIMA**

**Eduard SHALSI**